

## **Formular për SYLLABUS- Kirurgjia II (sem VIII)**

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Kirurgji II</b>
<b>Niveli:</b>	Mjekësi Veterinare
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>Viti IV, sem VIII</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>3+2(45/30)</b>
<b>Vlera në kredi - ECTS:</b>	<b>6</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof. Avni Robaj</b>
<b>Detajat kontaktuese:</b>	Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë e-mail: <a href="mailto:avni.robaj@uni-pr.edu">avni.robaj@uni-pr.edu</a> tel: +383 44 141 925
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	
	Kirurgjia II do të japë njohuri teorike dhe praktike mbi patologjitë e përgjithshme kirurgjikale. Studenti do të mësojë për sëmundjet kirurgjikale specifike të organeve dhe rajoneve të veçanta në lloje të ndryshme të kafshëve, përfshirë kirurgjinë e kokës, kirurgjinë torakale, kirurgjinë abdominale, kirurgjinë e stomakut, kirurgjinë e zorrëve, si dhe kirurgjinë e mëlçisë dhe të shpretkës. Trajtohet gjithashtu kirurgjia urogjenitale e kafshëve të vogla dhe të mëdha, përfshirë kirurgjinë e veshkave, të ureterëve, të fshikëzës së urinës dhe të uretrës. Diskutohen gjithashtu kryptohismi, prostata dhe aspektet kirurgjikale të barkut në kafshët e vogla. Programi përfshin ortopedinë e përgjithshme, ekzaminimet e qalimeve dhe parimet e përgjithshme të kirurgjisë së kockave, përfshirë trajtimin operativ. Neurologjia në kafshët e vogla trajtohet si pjesë e kursit, si dhe kastrimet në kuaj, gjedh dhe derra. Studentët do të mësojnë për inflamacionin e thundrave dhe sëmundjet navikulare, trajtimin e frakturave tek kuajt dhe sëmundjet e thundrave tek gjedh, dele dhe derra. Programi përfshin gjithashtu operacionet plastike, fashimet në rajone të ndryshme të trupit dhe imobilizimet.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Kirurgjia Veterinare do të japë njohuri teorike dhe praktike mbi patologjitë e përgjithshme kirurgjikale, duke përfshirë sëmundjet kirurgjikale specifike të organeve dhe rajoneve të veçanta në lloje të ndryshme të kafshëve. Pjesa praktike e programit, e njohur si kursi i operacioneve, përfshin temat kryesore të nevojshme për

	aftësimin praktik të përgjithshëm të studentëve në disiplinën e kirurgjisë. Në këtë program janë parashikuar ushtrime që do të realizohen kryesisht në kafshë të ngordhura, si element i ri që lejon aktivizimin e të gjithë studentëve. Demonstrimi i sëmundjeve kirurgjikale dhe aftësimi në kryerjen e operacioneve të veçanta do të realizohet gjatë orëve të demonstrimeve klinike në klinikat për sëmundjet e specieve të veçanta.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Studentët, pas përfundimit të kësaj lënde, do të jenë në gjendje, përmes ligjëratave dhe ushtrimeve praktike, të zotërojnë njohuri dhe aftësi në kryerjen e operacioneve në të gjitha rajonet dhe në të gjitha llojet e kafshëve shtëpiake, përfshirë kuajt, derrat, qentë, macet dhe gjedhin.

**Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)**

Aktiviteti	Orë	Ditë Javë	Gjithsej
Ligjërata	3	1/15	45
Ushtrime praktike (demonstrim klinik-praktik)	2	1/15	30
Kontakte me mësimdhënësin/konsultime	1	1/15	5
Projekte, prezantime, seminare.	1	3/-	3
Koha e studimit vetanak	1	1/15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	3	1/15	45
Kolokiume	2	2/-	4
Testi final	1	3/-	3
<b>Totali</b>			<b>150</b>

<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Mësimdhënia në lëndën Kirurgji II realizohet përmes ligjëratave teorike, seminareve interaktive dhe ushtrimeve praktike klinike. Ligjëratat synojnë paraqitjen e koncepteve të avancuara kirurgjikale dhe analizën e rasteve klinike, ndërsa seminarët fokusohen në diskutimin e protokolleve operative, komplikimeve dhe menaxhimin peri-operator. Pjesa praktike zhvillohet në ambiente klinike, ku studentët angazhohen në demonstrime dhe aplikime të drejtpërdrejta të teknikave kirurgjikale nën mbikëqyrje profesionale. Mjetet e mësimdhënies janë: prezantime me PowerPoint, projektor multimedial, materiale audio-vizuale (video demonstrative të procedurave kirurgjikale), demonstrime klinike në kushte reale, instrumente dhe pajisje kirurgjikale për ushtrime praktike
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Vlerësimi i studentëve në lëndën Kirurgji II realizohet në mënyrë të vazhdueshme dhe

	<p>përmbyllëse, sipas strukturës në vijim:  15% - Kolokiumi i parë me shkrim, i organizuar gjatë zhvillimit të ligjëratave  15% - Kolokiumi i dytë me shkrim, i organizuar gjatë zhvillimit të ligjëratave  10% - Vlerësimi i vijueshmërisë dhe angazhimit gjatë semestrit  60% - Testi përfundimtar</p> <p>Sistemi i notimit (6-10)</p> <p>Nota përfundimtare përcaktohet në bazë të përqindjes totale të pikëve të fituara gjatë semestrit dhe në provimin përfundimtar. Vlerësimi realizohet sipas kësaj shkalle:</p> <p>Studentët që arrijnë 50-59% të pikëve totale vlerësohen me notën 6,  Studentët që arrijnë 60-69% të pikëve totale vlerësohen me notën 7,  Studentët që arrijnë 70-79% të pikëve totale vlerësohen me notën 8,  Studentët që arrijnë 80-89% të pikëve totale vlerësohen me notën 9,  Studentët që arrijnë 90-100% të pikëve totale vlerësohen me notën 10.  Nota 5 konsiderohet notë jokaluere.</p>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<p>Auer, J. A. <i>Equine Surgery</i>. Philadelphia: Saunders, 1992.</p> <p>Baird, A. N., &amp; Dixon, J. M. <i>Advances in Small Animal Surgery: Essentials of Small Animal Surgery. Contemporary Techniques &amp; Complications Management</i>. Elsevier, 2022.</p> <p>Brinker, N. O., Piermattei, D. L., &amp; Flo, G. L. <i>Handbook of Small Animal Orthopedics and Fracture Treatment</i>. Philadelphia: Saunders, 1990.</p> <p>Dražen Matičić &amp; Dražen Vnuk. <i>Veterinarska Kirurgija i Anesteziologija</i>. Zagreb, 2010.</p> <p>Gjino, P. <i>Kirurgjia Veterinare</i>. Tiranë, 2007.</p> <p>Hodgson, D. R., &amp; Rose, R. J. <i>Equine Surgery and Lameness</i>. Elsevier, 2021.</p> <p>Slatter, D. H. <i>Textbook of Small Animal Surgery</i>.</p>

	<p>Philadelphia: Saunders, 2003.</p> <p>Solomon, J., &amp; Trout, D. <i>Small Animal Surgical Oncology</i>. Wiley-Blackwell, 2023.</p> <p>Verstraete, F. J. M., &amp; Lommer, M. J. <i>Oral and Maxillofacial Surgery in Dogs and Cats</i>. Wiley-Blackwell, 2021.</p> <p>Watson, A. <i>Current Techniques in Small Animal Surgery</i>. CRC Press, 2022.</p>
<b>Literatura shtesë:</b>	Paterson, H. M., Deans, C., Paterson-Brown, S., & Garden, O. J. (Eds.). <i>Core Topics in General and Emergency Surgery. Companion to Specialist Surgical Practice, 7th Edition</i> . Elsevier, 2023.
<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	Kirurgjia e kokës dhe qafës.
<b>Java e dytë:</b>	Kirurgjia e rrugëve të sipërme të frymëmarrjes në kafshët e vogla. Kirurgjia e toraksit në kafshët e vogla.
<b>Java e tretë:</b>	Diagnostikimi i kolikave në kuaj. Kirurgjia abdominale e kalit. Kirurgjia abdominale e gjedhit.
<b>Java e katërt:</b>	Laparatomia. Kirurgjia abdominale në gjedh dhe kafshë të vogla. Kirurgjia e stomakut. Herniet në kafshet e vogla dhe të mëdha. Kirurgjia e zorrëve.
<b>Java e pestë:</b>	Kirurgjia e mëlqisë dhe e shpretkes. Kirurgjia urogjenitale e kafsheve të vogla I. Kirurgjia e veshkave
<b>Java e gjashtë:</b>	Kirurgjia urogjenitale në kafshet e vogla II+III. Kirurgjia e uretereve dhe e fshikzës së urines. Kirurgjia e uretres Kryptorhismi. Prostata. Aspektet kirurgjikale të barkut në kafshë të vogla
<b>Java e shtatë:</b>	Ekzaminimet e qalimeve në kafshet e vogla. <b>Kolokium I.</b>
<b>Java e tetë:</b>	Ortopedia e pergjithshme. Parimet e pergjithshme të kirurgjisë së kockave. (trajtimi operativ)
<b>Java e nëntë:</b>	Neurologjia në kafshet e vogla.
<b>Java e dhjetë:</b>	Kirurgjia e sistemit urogjenital në kafshet e mëdha.
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Kastrimet në kuaj, gjedh, derra. Vlerësimi dhe deformimi i tyre
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Ekzaminimet e qalimit në kuaj.
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Inflamacioni i thundrave, semundjet navikulare.
<b>Java e katërmëdhjetë:</b>	Sëmundjet e thundrave në gjedh, dele dhe derra.
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Trajtimi i frakturave në kuaj. Parimet e pergjithshme të kirurgjisë së kuajve. <b>Kolokium II.</b>
<b>Literatura shtesë:</b>	<i>Listoni literaturën e rekomanduar/shtesë.</i>

<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Praktika që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	Kirurgjia e kavitetit oral në kuaj
<b>Java e dytë:</b>	Kirurgjia e kokës dhe e qafës në kafshet e vogla dhe të mëdha
<b>Java e tretë:</b>	Kolikrat, diagnostikimi i tyre
<b>Java e katërt:</b>	Celiotomia
<b>Java e pestë:</b>	Kirurgjia e traktit gastrointestinal
<b>Java e gjashtë:</b>	Kirurgjia e traktit urogjenital
<b>Java e shtatë:</b>	Diagnoza dhe terapia praktike dhe kirurgjikale I.
<b>Java e tetë:</b>	Diagnoza dhe terapia praktike dhe kirurgjikale II.
<b>Java e nëntë:</b>	Diagnoza dhe terapia praktike dhe kirurgjikale III.
<b>Java e dhjetë:</b>	Kastrimi në kafshët e mëdha.
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Diagnostifikimi i Çalimeve I.
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Diagnostifikimi i Çalimeve II. Ekzaminimi i kuajve me laminit. Ushtrime dhe teste provokimi. Çalimet III.
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Praktika në kuaj me ekspert nallban.
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Laparatomia në gjedh.
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Kolokium përfundimtar